

**RENOVA**[®]*Innovation & Performance*

RENOGRUND

Detyrimisht përmbahuni udhëzimit teknik

FUSHA E APLIKIMIT

RENOGRUND (astar) i gatshëm i dedikuar për sipërfaqe të jashtme dhe të brendshme. Renogrund është astar universal i cili barazon absorbimin në të gjitha pjesët e murit.aplikuar në murë ajo depërton thellë në bazën minerale dhe e lidh ate me të, duke e bërë më të fortë dhe më të qëndrueshme, të gatshme për aplikim sa më të lehtë të përfundimit të llaçeve dekorative dhe bojrave. Ngjyroset në të gjitha nuansat për ta bërë më të lehtë efektin e dëshiruar për shtresën përfundimtare.

PËRMBAJTJA

- Lidhës akrilik
- Titan, mbushësa mineral
- Aditive, antishkuma

VEÇORITË

- Adhezion i lartë
- Apsorcioni i njëjtë i ujit në tërë bazamentin
- Redukton apsorbcionin e ujit në bazament
- Pa tretësa dhe hollues

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Nënshtresa (bazamenti) duhet të jetë e thatë, e pastër, e fortë, pa pluhur, pa plasaritje, shtresa të ndara dhe papastërti të çdo lloji.

Nëse bazamenti është beton, duhet të jetë i qëndrueshëm, i thatë, i pastër dhe pa pluhur. Para aplikimit të RENOGRUND - it duhet hequr të gjitha papastërtitë nga bazamenti, sidomos mbetjet e vajrave, blozës, algave, myshkut, etj. Plasaritjet, disavantazhet e substratit ose pjesët ku ka mbetjet të bojës së vjetër me yndyrë duhet të rrafshohen mekanikisht dhe të mbushen me materiale të përshatshme (Renofix 5 ose Renofix 15).

PËTGATITJA E MATERIALIT

Para përdorimit, të hollohet me 1 - 2 % ujë të pastër dhe të përzihet mirë. Për llaçe përfundimtare, astari RENOGRUND rekomandohet gjithashtu që të pigmentohet në nuancën në të cilën është edhe shtresa përfundimtare. Tek llaçet e mozaik (KULIRPLAST) rekomandohet që astari të pigmentohet me nuansë më të erët nga nuanca e llaçit përfundimtarë.

KUSHTET E PËRDORIMIT

Gjatë aplikimit të RENOGRUND -it, temperatura e ambientit nuk duhet të jetë më e ulët se + 5 ° C. Duhet shmangur rrezet direkte të diellit. Koha e tharjes do të varet nga ndikimet e jashtme, në temperaturë prej 20 ° C dhe 65% lagështia relative e ajrit, koha e tharjes është 5 orë, ndërsa plotësisht e tharë pas 3 ditëve.

PËRPUNIMI

Aplikohet me furçë, rul ose maqinë për spërkatje deri sa të arihet mbulesë e njëtrajtshme e bazamentit.





SHËNIM

Para përdorimit, lexoni udhëzimet dhe gjatë aplikimit të këtij produkti, duhet pasur kujdes normat dhe rregulloret kombëtare dhe evropiane, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare në këtë lëmi. Për të gjitha paqartësitë ju lutemi konsultoheni me ne.

VËREJTJE

Të mbahet larg nga fëmijët. Në rast të kontaktit me sytë ose lëkurën, të pastrohen me ujë të ftohtë. Nëse ASTARI aplikohet me makinë me spërkatje, të përdoret një maskë në mënyrë që të mos thithen avujt që dalin nga procesi i spërkatjes.

FURNIZIMI

Në kova plastike prej 3 kg, 10 kg dhe 20 kg. Paketuar në paleta prej 144, 48 dhe 24 kova.

DEPONIMI

Të ruhet në paketim origjinal të mbyllur mirë në temperatura prej + 5 ° C deri + 25 ° C të mbrohet nga rrezet e direkte të diellit dhe nga ngricat. Afati i ruajtjes 12 muaj në paketimin origjinal, të mbyllur mirë.

TË DHËNAT TEKNIKE

Shifra e prodhimit		RF01 1142		
Paketimi		Kova		
Sasia e paketimit		3 kg	10 kg	20 kg
Kova në paletë		144	48	24
Analizat				
Pamja e shtresës së tharë	vizuele	Lëng bezh-roze		
Përmbajtja e substancave jo të avullshme (NV)	MKS EN ISO 3251	53,74 %		
Koha e lidhjes dhe e tharjes në 20°C	MKS EN ISO 9117-1	T = 290 min.		
Elasticiteti në shtresë prej 1 mm	MKS EN ISO 1519	(Ø10 mm) nuk ka plasaritje		
Vlera pH (tretur me 1,5 % ujë)	pH - metër	8,6		
Viskoziteti sipas Brookfield	EN ISO 2555:2003	7900 mPa.s		
Dendësia	EN ISO 2811-1:2016	1,49 kg/m ³		
Përshkueshmëria e ujit të lëngët	EN 1062- 1:2006	ca. W3		
Shkalla e transmetimit të avullit të ujit	EN 1062-1:2006	Category V1		
*vetitë e transmetimit të avujve të ujit *faktori i rezistencës së difuzionit të avujve të ujit. *difuzioni i avujve të ujit ekuivalent-trashësia e shtresës	EN 1062-1 : 2006	Category V1		

Me këtë listë, të gjitha informacionet e mëparshme materiale nuk janë të vlefshme. Këto të dhëna korrespondojnë me gjykimet tona aktuale. Ky informacion nuk mund të rezultojë në një detyrim ligjor. Produktet RENOVA si dhe të gjitha lëndët e para janë subjekt i kontrollit të vazhdueshëm për të arritur cilësi të njëtrajtshme. Këshilltarët tanë teknikë janë në dispozicionin tuaj për pyetje të aplikimit, përpunimit dhe prezantimit të produkteve tona. Ju mund të gjeni gjendjen aktuale të të dhënave tona teknike në faqen tonë të internetit; www.renova.com.mk, si PDF ose mund t'i kërkonit ato në sektorin e shitjes.

RENOVA MAQEDONI

Xhepcisht / Tetove

Tel: +389 44 487 300

Fax: +389 44 487 200

info@renova.com.mk

RENOVA SHQIPERI

Picar / Vore

Tel: +355 48 301 909

Fax: +355 48 301 908

tirana@renova.com.mk

RENOVA KOSOVE

Gurëza / Ferizaj

Tel: +381 290 310 222

Fax: +381 290 310 444

ferizaj@renova.com.mk

COMPANY CERTIFIED BY



EN ISO 9001

Certificate No: FM 503328